REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

**INSPEKTORIATI I MBROJTJES SË TERRITORIT**

Nr. 784/6 Prot  Shkodër, më 24. 2 .2025

Lënda: Njoftim për afishim në Web-in e Bashkisë

**DREJTORIA E IT-SE**

Me **datë 14.02.2025** është ushtruar kontroll në adresën**: rruga e Shirokës, Rajoni Nr.1, Shkodër.** Nga ky kontroll është konstatuar vendosje e një objekti me konstruksion metalik e mbuluar me material sanduiç, me pesë kolona nga 3m. Kolonat janë metalike dhe objekti ka sipërfaqe rreth $60m^2$. Bazuar në ligjin 9780 dt 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundraligjshme" i ndryshuar, ligjit Nr 107, dt 31.07.2014 "Për planifikim e territorit i ndryshuar, neni 52 pika për shkeljen ndërtim pa leje ndërtimi inspektorët e IMT Bashkia Shkodër mbajtën "Proçes-verbalin e konstatimit të kundravajtjes" nr.07 datë 14.02.2025. Një kopje e këtij proçes- verbali u la në objekt.

Bazuar në nenin 5 pika ç dhe b, neni 12 të ligjit nr 9780 dt 16.07.2007 " Pë Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundraligjshme i ndryshuar , si dhe VKM nr 894 dt 04.11.2015 "Për unifikimin e proçedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati Kombëtar I Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore" nga Kryeinspektori është marrë **Vendim per prishjen e Objektit te Kunderligjshem nr.1054, datë 21.02.2025 (Bashkelidhur).**

Kërkojmë nga ana Juaj të bëni shpalljen publike sipas nenit 133 K.Pr Civile nenit 162 e vijues i K.Pr Administrative ku të afishohen aktet në faqen **Web të Bashkisë Shkoder për një afat 15 ( pesëmbëdhjetë ditor)** dhe të vihet në dijeni IMT-ja pas mbarimit të afatit të shpalljes.

Duke ju falenderuar!

**KRYEINSPEKTOR**

**Pjerin Lazri**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

**INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT**

SERIA NR: 0001054

**VENDIM**

**NR. 1054 DATË 21 / 02 / 2025**

**PËR**

**PRISHJEN E OBJEKTIT TË KUNDËRLIGJSHËM**

Në bazë të proces verbalit nr. 07 datë 14 / 02 / 25, me nr. Serie 0001972, inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, pasi ushtruan një kontroll në subjektin juridik / fizik I pa identifikuar, në adresën Rruga e Shirokës, Lagjia nr. 1, Shkodër, kanë konstatuar kundërvajtjen/t administrative Punime ndërtimore pa dokumentacion tekniko-ligjor. Ndërtim objekti me konstruksion metalik e mbuluar me material sanduic, objekti ka 5 kolona me material metali me lartësi 3m. Objekti ka sipërfaqe rreth 60 m². të parashikuar nga Ligji 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar me ligjin 41/2024, neni 52, germa "e",

**PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në Ligjin Nr. 9780, datë 16.07.2007, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme ", i ndryshuar, neni/et 4, 5 dhe 12, si dhe VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave mes IKMT me IMT e njësisë vendore" Ligjin 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 52, germa "e",

**VENDOSA:**

Dënimin e kundërvajtësit I pa identifikuar

me prishjen e objektit të kundërligjshëm objekt me konstruksion metalik e mbuluar me panele sanduic, rreth 60 m²,

ndodhur në adresën Rruga e Shirokës, mbi rrugë ~~pranë~~ me koordinata N 42°03' 14" dhe E 19°28'55", pa shkuar te Restorant "Arbri".

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i drejtëpërdrejtë në gjykatë, brenda 10 (dhjetë) ditëve, duke filluar nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi gjyqësor kundër këtij vendimi nuk pezullon ekzekutimin e tij.

**KRYEINSPEKTORI**

Pjerin [signature]